



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA JURIDIKE DHE PËRPUTHSHMËRISË SË STANDARDEVE
SEKTORI I PROKURIMEVE**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2024

Shtojca 13

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

25.10.2024

Drejtuar: **Operatorit Ekonomik “BE - IS SH.P.K”**

Kukes KALIS Godina Nr.2, Heci Veleshice, Kalis, Zall Kalis, Kukes

Procedura e prokurimit: **Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - Shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-10941-06-24-2024**

Numri i referencës së **Lotit 10: REF-10961-06-24-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Kontrata punimesh dhe Mirëmbajtje të rrugëve nacionale (kontratat e mirëmbajtjes), Rajoni Verior Shkodër”**

- Loti 10: Mirëmbajtje me performancë rruga “Kukës - Bushtricë (Vasije)” (gjatësia totale 34 km), me vlerë totale **132,954,064** (njëqind e tridhjetë e dy milion e nëntëqind e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëdhjetë e katër) **Lekë pa TVSH;**

Në Euro: **1,326,092.79** (një milion e treqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e nëntë) **Euro pa TVSH.**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: **48 muaj**

Publikimet e mëparshme: **Buletini i Njoftimeve Publike Data 1 Korrik 2024, Nr. 34**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

Sipas rëndësisë:

- **Çmimi** pikët [0 - 60]
- **Përvoja në shërbime të ngjashme** pikët [0 - 20]
- **Cilësia** pikët [0 - 15]
- **Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social** pikët [0 - 5]

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

I. "BE - IS SH.P.K" **K71412003A**
II. "CURRI" SHPK **J67902718S**
III. BOE "OUEN" SHPK & "SHPRESA-AL" SHPK **K175292150 / K31321021N**

Njoftojmë se kanë qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar ofertuesi me vlerën përkatëse të ofruar:

I. "BE - IS SH.P.K" **K71412003A**

Vlera / Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme):
112,857,409 (njëqind e dymbëdhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e nëntë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **281,85**

II. BOE "OUEN" SHPK & "SHPRESA-AL" SHPK **K175292150 / K31321021N**

Vlera / Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme):
106,723,001.95 (njëqind e gjashtë milion e shtatëqind e njëzet e tre mijë e një pikë nëntëdhjetë e pesë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **279,15**

III. “CURRI” SHPK

J67902718S

Vlera / Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme): **117,288,520.5** (njëqind e shtatëmbëdhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e njëzet pikë pesë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **271,95**

Janë skualifikuar Operatorët Ekonomikë të mëposhtëm:

I. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “EUROKOS HOLDING” & “ABI CONS” K91727010A / L41525007G

Skualifikohet, pasi nuk përmbush, kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 77, të LPP-se, si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit.

Operatoreve ekonomik **“EUROKOS HOLDING”** i cili sipas kontrates së bashkepunimit do të realizojë 90 % të shërbimit, nuk përmbush kriterin 2.3.1 “Operatori ekonomik duhet të paraqesë **dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme**, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të lotit përkatës**, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit”.

Operatori ekonomik ka paraqitur punë të ngjashme rehabilitim e cila ze maksimale deri në 40 % të përmbushjes së kriterit 2.3.1 ,

Lidhur me shërbimet e ngjashme të cilat zënë minimalisht 60% (mirembajtje rutine me performance dhe emergjenca), operatori ekonomik ka paraqitur dy kontrata shërbimi me objekt ” Mirembajtje verore dhe dimerore e rrugeve nacionale dhe rajonale të Kosoves per vitet 2022-2023, 2023-2024 dhe 2024-2025 Regjioni Gjilani 2 Loti 13 dhe ” Mirembajtje verore dhe dimerore e rrugeve nacionale dhe rajonale të Kosoves per vitet 2022-2023, 2023-2024 dhe 2024-2025 Regjioni Ferizaj 1, Loti 10 ,

Kontratat e shërbimit cituar me sipër janë me afat 36 muaj, kontratat fillojnë në vitin 2022 dhe përfundojnë në vitin 2025. Nga operatori ekonomik EUROKOS HOLDING nuk janë bashkelidhur kontratat e sipercituara, gjithashtu nga të dhënat e listës së disbursimeve vëmë re se kontrata është lidhur ndërmjet shtetit të Kosovës dhe 5 operatoreve ekonomik. Operatori nuk ka bashkelidhur kontratën e bashkepunimit me BOE në mënyrë që të përcaktohet vlera e punimeve të realizuara nga Operatori ekonomik EUROKOS HOLDING, sipas % së bashkepunimit në këto dy kontrata shërbimi. Gjithashtu nuk kemi paraqitur Formularin e vlerësimit ose leter reference, akt kolaudimi ose raport përfundimtar të punimeve të shoqëruara me faturat + çertifikatën e zhvillimit financiar të kontratës + paramasa dhe parallogaria

Kriteri konsiderohet i papermbushur nga operatori ekonomik.

II. Operatori ekonomik “JUBICA”

K26529001I

Skualifikohet, pasi nuk përmbush, kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 77, të LPP-se, si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit.

Operatori ekonomik “JUBICA” nuk përmbush kriterin 2.3.4 “*Kandidati ofertues duhet të disponojë 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, i cili do të jetë Drejtues teknik i punimeve/shërbimeve, i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen shërbimet / punimet në objekt. Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.*

-Drejtuksi teknik i shërbimeve/punimeve i deklaruar nga Jubica është i angazhuar në Kontraten me objekt “Permiresim i sinjalistikes horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e rajonit Verior , Loti 1 (2024).

III. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “HAZIRI & ARIFAJ” J66702916G / J76418907K

Skualifikohet, pasi nuk përmbush, kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 77, të LPP-se, si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit.

Operatori ekonomik “HAZIRI” nuk përmbush kriterin 2.2.1 “*.....operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës (vlera e fondit limit)*”.

-Operatori ekonomik “HAZIRI” nuk ka paraqitur xhiron e kërkuar në perputhje me % (51%) e bashkëpunimit, kjo në kundërshtim me nenin 88 të Vendimit 285, datë 19.05.2021 “Rregulla të Prokurimit Publik” pika 3 citon “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

-Operatori ekonomik “HAZIRI” nuk përmbush kriterin 2.3.1 “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të lotit përkatës, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit”.

Operatori ekonomik “HAZIRI” nuk ka paraqitur shërbim të ngjashëm për të përmbushur kriterin 2.3.1 në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes (51%) sipas kontratës së bashkëpunimit (shërbimi i ngjashëm që duhet të plotësojë operatori HAZIRI sipas % se bashkëpunimit është jo më e vogël

se vlera 20,341,972 leke, operatori ka paraqitur sherbim te ngjashem, **te realizuar gjate tre viteve te fundit nga njoftimi i kontrates** ne vleren 18,585,346 lek. Pra vlera e sherbimit te ngjashem te paraqitur nga operatori eshte me e vogel se vlera e kerkuar sipas % se kontrates se bashkepunimit, kjo ne kundërshtim me nenin 88 te Vendimit 285, date 19.05.2021 “Rregulla te Prokurimit Publik” pika 3 citon “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*”

Ne kete procedure operatori ekonomik ka paraqitur pune te ngjashme e cila permbush vetem 40 % te kriterit qe perkon me rehabilitimin. Operatori nuk ka paraqitur asnje sherbim te ngjashem (rrutine me performance) te kerkuar nga autoriteti kontraktor ne piken 2.3.1..

Operatori ekonomik “**ARIFAJ**” nuk përmbush kriterin 2.3.1 “Operatori ekonomik duhet të paraqesë **dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme**, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të lotit përkatës**, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit”.

-operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje sherbim te ngjashem (mirembajtje rrutine me performance) e cila ze 60% te vleres se kontrates sipas percaktimit ne specifikimet teknike si dhe ne preventivat e publikuara mirembajtja rutine me performance te cilat prevalojne ne kete kontrate sherbimi duke zene minimalishte 60 % te vleres se kontrates, kundrejt vleres maksimale deri ne 40 % te punimeve te rehabilitimit.

Ne kete procedure operatori ekonomik ka paraqitur pune te ngjashme e cila permbush vetem 40 % te kriterit qe perkon me rehabilitimin. Operatori nuk ka paraqitur asnje sherbim te ngjashem (rutine me performance) te kerkuar nga autoriteti kontraktor ne piken 2.3.1. **Kriteri konsiderohet i pa permbushur nga bashkimi i operatoreve ekonomikë.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se **OE “BE - IS SH.P.K”** me Nr. Nipti: **K71412003A** dhe adresë: Kukes KALIS Godina Nr.2, Heci Veleshice, Kalis, Zall Kalis, Kukes, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Vlera / Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme): **112,857,409** (njëqind e dymbëdhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e nëntë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **281,85**

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqisni **AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR**, adresa: “Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë, Tel/Faks : +355 4 2234487, E-mail: info@arrsh.gov.al sigurimin e kontratës brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Ankesat: (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr dhe datë): **Nuk ka pasur.**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Gentian Gjyli